

**Dr. Sc. Nikë Ukgjini**  
**Instituti Filozofik e Teologjik, Shkodër**

## **KËRCËNIMI SLLAV- KRAHINA E RUGOVËS NË SHITIGJET HISTORIKE DERI MË 1913**

### **Shkurtore**

Për lashtësinë e kësaj treve bjeshkore, nuk është arritur të bëhen hulumtimet e duhura, por, me siguri që, pos fshatit Shtupeq, që është një ndër fshatrat më të njohur të Rugovës, dhe që përmendët në fillim të shek. XIII-XIV, (1293-1302), do ketë pasur edhe vendbanime të tjera në këtë zonë kaq piktoreske, nga ku janë kryqëzuar rrugët: Pejë, Budilmje, Diokle, Kotor e Raguzë dhe Pejë-Plavë e Guci, Shkodër. Në pragun e shkatërrimit të Perandorisë Osmane në fillim të shek. XIX, dhe ndarjes më të re dhe të fundit të trevave shqiptare në vilajete, Rugova i përkiste vilajetit të Kosovës. Shënimet e para drejtpërsëdrejti si krahinë lidhen me trazirat e ndodhura në Veri të Shqipërisë në mesin e shek. XVIII, kur fiset e Malësisë, organizuan kryengritje të ashpra kundër turqve në vitin 1700, angazhoi, Pashain e Shkodrës e Dukagjinit, Hodoverd Mahmutbegoviqin (1699-1738) i cili gjakosi keqas Malësinë, e ku me këtë rast filloi dyndja dhe shpërngulja e Kelmendasve, për në Sjenicë, Peshtër, Rozhajë, e deri në Srijem të Vojvodinës. Kësaj shpërnguljeje në vitin 1736, iu bashkuan edhe Hoti, Gruda e Dukagjini, Shkreli e Kastrati. Për fisin e Kelmendit në Rugovë dhe për rivendosjen e tij nga viti 1702, në qershor, mësojmë nga relacionet e ipeshkvijve të Tivarit dhe Shkupit, dërguar Selisë së Shenjtë në Romë, ku për së pari herë del emri i krahinës së Rugovës. Arqipeshkëvi i Tivarit, Vinçenc Zmajeviq, në relacionin e tij të vitit 1702, në nëntor, prej atyre që kishin ardhur, ndejën dhe u vendosën në krahinën e Rugovës, figurojnë se ishin 8 familje me 50 banorë. Në relacionin e mëvonshëm të 4 gushtit të vitit 1719, arqipeshkvi Karagaçi, flet” për Plavën, Rugovën dhe fshatrat përreth. Aarqipeshkvi thotë se “janë mbi 500 frymë.” Po për Rugovën, flet, arqipeshkvi Mati Mazrreku, Imzot Gjon Logoreci, Imzot Lazer Mjeda etj. Për trysnitë e

manastirit serb të Pejës ndaj rugovasve, që kishin filluar të islamizoheshin dhe katolikëve të Pejës, na flasin shënimet e Atë Bonaventurës nga Kastrati në vitin 1779. Sipas shënimeve të udhëpërshkruesit serb, Teodor Stankoviq, Rugova kishte një potencial të madh të popullatës, sepse në vitin 1910, kishte rreth 800 shtëpi. Me plasjen e luftës ballkanike, në vitin 1912, kur serbët e malazezët, tentonin zgjerimit e kufijve në Veri të Shqipërisë deri në lumin Mat, Austro-Hungaria, zhvillonte betejën e saj diplomatike në Londër 1912-1913, që as Kosova të mos i takojë Serbisë e Malit të Zi. Mirëpo, Serbia e Mali i Zi, për ta vendosur Konferencën e vitit 1913, para faktit të kryer, me direktivat e Patriarkut serb, nëpërmjet Manastirit të Pejës, kryente spastrime etnike në forma të ndryshme, duke shkaktuar viktima të shumta dhe masakra në fshatrat përreth Pejës, e sidomos në zonën e Rugovës, e cila ishte e populluar e gjitha vetëm me shqiptarë e ku vetëm prej një shtëpie kanë vlarë 20 anëtarë të saj. Kjo dhunë e tërbuar e shoqëruar me pagëzimin dhe ripagëzimin e shqiptarëve e filluar në korrik 1912, që ndërprerë në prill të vitit 1913, kur Austro-Hungaria, kërcënonte më shpalljen e luftës ndaj Serbisë e Malit të Zi. Mirëpo, në vitet e mëvonshme, me pastabilitetin gjeopolitik në Evropë dhe në Ballkan, mjerisht përsëri solli viktima të tjera shqiptare në zonën e Rugovës dhe jashtë saj, kudo që kishte shqiptarë për të shuar oreksin e sllavëve me tokat shqiptare në këtë pjesë të Ballkanit.

**Fjalët çelësa:** Rugova, Peja, Mali i Zi, Kisha Ortodokse.

### **Diçka rreth kelmendasve dhe rugovasve**

Për lashtësinë e kësaj treve bjeshkore, nuk është arritur të bëhen hulumtime të duhura, por, me siguri se pos fshatit Shtupeq, që është një nder fshatrat më të njohur të Rugovës, që përmendet në fillim të shek. XIII-XIV, (1293-1302),<sup>367</sup> do ketë pasë edhe vendbanime të tjera në këtë zonë kaq piktoreske, nga ku janë kryqëzuar rrugët: Pejë, Rozhajë, Budilmje, Diokle, Kotor e Raguzë dhe Pejë-Plavë e Guci për Shkodër.<sup>368</sup>

<sup>367</sup> Mirko BAJRAKTAREVIĆ, Rugova, *Naselja i poreklo Stanovništva*, knjiga 36, Srpska Akademia Nauka i Umjetnosti, Beograd, 1960, f. 172.

<sup>368</sup> Mirko BAJRAKTAREVIĆ, vepër e cituar, f. 168-169.

Me reformat e administrative të ndërmarra të njëpasnjëshme nga pushtuesit osmanë, ne këtë trevë në fillim të shek. XVII e gjejmë si pjesë e Sanxhakut të Dukagjinit, kur më parë i takonte Sanxhakut të Shkodrës. Kurse në pragun e shkatërrimit të Perandorisë Osmane në fillim të shek. XIX, dhe ndarjes më të re dhe të fundit të trevave shqiptare në vilajete, Rugova i përkiste vilajetit të Kosovës. Popullsia shqiptare e sotme e këtyre trevave, e ardhur nga Malësia e Madhe, u vendos në Rugovë në fillim të shek. XVIII.<sup>369</sup>

Për shkak të sulmeve të shpeshta të kelmendasve në qytetin e Plavës dhe të Gucisë, të cilët ishin nën pushtimin turk, dhe për të penguar depërtimin e tyre, pushteti osmanli që në vitin 1612, kishte ndërtuar një kështjellë mbi fshatin Gernçar pranë Gucisë në një kodër të quajtur Godile.<sup>370</sup> Kjo kodër mbyllte hyrjen nga Selca në Guci. Kjo godinë ishte ngritur me urdhrin e pashait të Shkodrës Ali Çengiqit pasi në Plavë gjendej timari i tij,<sup>371</sup> të cilin ai nuk mund ta shfrytëzonte për shkak të sulmeve të kelmendasve.<sup>372</sup> Për këtë tregon shkrimi i Marijan Bolicës nga Kotori, në përshkrimin e sanxhakut të Shkodrës.<sup>373</sup>

Në vitin 1624, siç pohon Franz Baron Nopcsa, kelmendasit bashkë me fiset e tjera të maleve, u ngritën kundër turqve, të cilët ishin të fortifikuar në Guci dhe çliruan fshatrat përreth duke jetuar si fshatarë të lirë.<sup>374</sup> Në këtë kryengritje kelmendasit u shquan më së shumti, pasi u shkonte në favor edhe pozita e tyre gjeografiko-strategjike. Turqit përdorën metoda nga më të ndryshmet për ta qetësuar këtë fis luftarak, duke u dhënë edhe disa privilegje, mirëpo pa sukses të denjë. Pas kësaj disfate të madhe, në vitin 1638 pushteti turk dërgoi ekspeditën ushtarake nga Bosnja, në krye me Vuço-pashain kundër Malësisë, përkatësisht

<sup>369</sup> Shukri RAHIMI, *E kaluara historike e Rugovës: në Rugova, Monografi Etnografike*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosoves, libri 6, Prishtinë, 1987, f. 16.

<sup>370</sup> Andria JOVIČEVIĆ, *Plavsko-gusinjska oblast: Srpski etnografski zbornik*, knj. XXI, Beograd, 1921, f.411.

<sup>371</sup> Timar, është len feudale e cila i ka sjellë Perandorisë osmane 20. 000, argjenditë në vit.

<sup>372</sup> Šime LJUBIĆ, *Marijan Bolica Kotoranin: Opis Sandžakata skadarskoga od godine 1614: Starine JAZU*, knj. XII, Zagreb, 1880, f.183.

<sup>373</sup> Peter BARTL *Die Kelmendi. Zur Geschichte eines nordalbanischen Bergstammes*: Shejzat, Roma, 1977, f. 126.

<sup>374</sup> Franc Baron NOPCSA, *Die Bergestämme Nordsalmaniens und ihr Gewohnheitsrecht*, Österreichische Nationalbibliothek, (dorëshkrim), Wien, 1913, Ser. Nov. 9392, f. 186.

kundër kelmendasve.<sup>375</sup> Në fillim të shkurtit të atij viti, Vuço-pasha me 15.000 ushtarë u nis nga Bosnja me synim Malësinë kundër kelmendasve.<sup>376</sup> Këtë aksion turqit e ndërmorën për shkak se fisi i Kelmendit plaçkiste shpesh në Bosnjë, Serbi e deri në Pllodiv në Bullgari dhe kështu zinte rrugët, të cilat shkonin nga Stambolli për Bosnjë.<sup>377</sup> Njerëzit nga Bosnja i ankoheshin Portës për plaçkitjet e kelmendasve. I pezmatuar me aksionet e kelmendasve, sulltani u përgjigj në mënyrë të egër: urdhëroi pashain turk në Bosnjë që të bashkonte sa më shumë ushtarë dhe pa vonesë të nisej kundër Shqipërisë, ku duhej me çdo kusht ta zhbinte fisin e Kelmendit: “le të marrë me vete pashai edhe litarin, po qe se nuk i shkatërron kelmendasit, atëherë më së miri le ta varë veten,” porositi sulltan Murati IV (1623-1640).<sup>378</sup>

Posa nga Stambolli u mor urdhri, Vuço-pasha shpejtoi ta realizonte. Mblodhi “*disa dalmatinë, kroatë, serbë, bullgarë dhe një shumicë boshnjakësh: të gjithë ata ishin shtatgjatë dhe mbanin mjekra të gjata, por rëndësi të vogël ushtarake*”.<sup>379</sup> Me këtë ushtri që kishte afro 15.000 ushtarë, Vuço-pasha arriti në Shqipëri, thirri sanxhakbeun e Shkodrës, AliÇengiqin, përmes të cilit mblodhi edhe 1000 shqiptarë myslimanë dhe kriptokatolikë, dhe më në fund u sul drejt Kelmendit.<sup>380</sup> Ndërkohë kelmendasit u tërhoqën nga fshatrat e veta në vendet e larta malore duke marrë me vete gratë, fëmijët, drithin dhe bagëtiti. Ishte muaji shkurt në mes të dimrit. Ushtria turke u mërzit duke pritur se kur do të ktheheshin kelmendasit në shtëpitë e veta. Pas plot tetë ditësh, pikërisht më 7 shkurt të vitit 1638, kelmendasit vendosën të sulmojnë turqit.<sup>381</sup> Sulmuan rrufeshëm dhe fuqishëm duke vrrarë shumë ushtarë, duke i sjellë disfatë të rëndë ushtrisë. Kur pa se iu vra ushtria Vuço

<sup>375</sup> Injac ZAMPUTI, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të mesme në shekullin XVII*.(1634-1650) vol. II, Tiranë, 1965. f.163; Peter BARTL, *Die Kelmendi. Zur Geschichte eines nordalbanischen Bergstames*: Shejzat, Roma, 1977, f. 129.

<sup>376</sup> Injac ZAMPUTI, po aty; P. BARTL po aty.

<sup>377</sup> Peter BARTL, *Die Kelmendi. Zur Geschichte eines nordalbanischen Bergstames*: Shejzat, Roma, 1977, f. 126.

<sup>378</sup> Frang BIANCHI, (Letër Kongregacionit): ACPF, VC, vol. 17, anno, 1638, f. 159v. (dorëshkrim).

<sup>379</sup> Po aty.

<sup>380</sup> Po aty.

<sup>381</sup> Peter BARTL, *Die Kelmendi. Zur Geschichte eines nordalbanischen Bergstames*: Shejzat, Roma, 1977, f. 129.

pasha, i cili qëndronte jashtë fshatit të Kelmendit, mbledhi ata që kishin mbetur dhe u kthye në Shkodër.<sup>382</sup> As Plava e fortifikuar dhe as Gucia nuk kishin mundur të pengonin hyrjet e kelmendaseve në ato vise. Me rastin e depërtimit në ato vise, kelmendasit e shkatërruan me kulm dhe themel kështjellën e fortifikuar, të cilën e mbronte Mahmut-beu në Guci.<sup>383</sup>

“Sa kohë qëndroi në Shkodër, bëri një mijë të zeza kundër të krishterëve në të gjitha dioqezat duke i torturuar. Popullit i duhej të qëndronte jashtë shtëpive në mes të dimrit, sepse shtëpitë ishin të detyruara t’ua lëshonin ushtarëve. E njëjta gjë ishte edhe me ushqime. Njerëzit duhej ta ndanin kafshatën e gojës dhe t’ua jepnin ushtarëve”, rrëfen ipeshkvi i Sapës, Frang Bardhi në raportin e tij dërguar Kongregacionit për përhapjen e fesë në vitin 1638.<sup>384</sup> Kelmendasit e provokonin mjaft Vuço pashën sa kohë ai qëndroi në Shkodër, duke e tallur, se vetë papa i Romës i kishte bekuar për të qenë më të fortë se turqit.<sup>385</sup>

Pasi Vuço pasha nuk arriti ta nënshtrojë Malësinë, qeveria turke në vitin 1700, angazhoi, Pashain e Shkodrës e Dukagjinit, Hodoverd Mahmutbegoviqin (1699-1738) i cili kishte djegur e shkretuar Malësinë. Me këtë rast filloi dyndja dhe shpërngulja e Kelmendasve që përbëhej nga vëllazëritë, Selca, Vukli, Nikçi e Boga,<sup>386</sup> duke ikur për në Sjenicë, Peshtër, Rozhajë, Rugovë, pastaj në Bosnje dhe deri në Srijem.<sup>387</sup> Një pjesë e fisit e pranoi pushtetin turk, duke shprehur gatishmërinë të jetonin si lojal në viset e Plavës dhe Gucisë. Meqenëse dhuna ishte shtrirë dhe në pjesët e tjera të Malësisë nga kjo zonë u shpërngulën për në Sanxhakun e Novipazarit disa shtëpi Hot e Grudë dhe në Rugovë: pjesëtarë të fiseve, të Kelmendit, Shkrelit, Kastratit e Shalës.<sup>388</sup> Pas

<sup>382</sup> Fancesco BIANCHI, (Letër Kongregacionit): ACPF, VC, vo1. 17, anno, 1638, f. 150v-161, (dorëshkrim).

<sup>383</sup> Miomir DAŠIĆ, *Vasojevići od pomena do 1860. godine*, Beograd, 1986, f. 108-109.

<sup>384</sup> Francesco BIANCHI vepër e cituar, f. 161.

<sup>385</sup> Po aty.

<sup>386</sup> Mirko BAJRAKTAREVIĆ, *Rugova, Naselja i poreklo Stanovništva*, knjiga 36, Srpska Akademia Nauka i Umjetnosti, Beograd, 1960, f. 176.

<sup>387</sup> Nikë dom UKGJINI, *Kisha katolike në Trevat Shqiptare (Nga shek., XI-deri sot)*, Qendra botuese, Shoqata e Jezuitëve, Tiranë, 2016, f. 90.

<sup>388</sup> Mirko BAJRAKTAREVIĆ, *Rugova, Naselja i poreklo Stanovništva*, knjiga 36, Srpska Akademia Nauka i Umjetnosti, Beograd, 1960, f. 177.

humbjes së luftës së austriakëve nga turqit në vitin 1736-1737, Kelmendasit u shpërngulën në Srijem në fshatrat; Nikinci, Hrtkovac, Jarak, 300 familje e ku me ta ishte dhe kryepeshkvi i Shkupit, Mëhill Suma (1728-1743) të cilin e gjejmë të strehuar në dioqezën e Osjekut në Kroaci.<sup>389</sup>

Duke qenë të ndikuara nga situata politike, familjet e këtyre fiseve duke përfshirë dhe Kelmendin, kanë bërë lëvizje brenda fshatrave të zonës së Novi Pazarit: Rozhajës, Plavës e Gucisë, Rugovës dhe Pejës.

### Rugova në relacionet e Selisë së Shenjtë

Se sa e vështirë ishte gjendja e popullatës së shpërngulur nga Malësia në këto zona, e mësojmë nga relacionet e ipeshkvijve të Tivarit dhe Shkupit dërguar, Selisë së Shenjtë në Romë. Dhe për së pari herë del emri i krahinës së Rugovës.

Arqipeshkëvi i Tivarit, Vinçenc Zmajeviq, në relacionin e tij të vitit 1702, dërguar Kongregacionit për përhapjen e fesë ndër të tjera thotë se pjesëtarët e fisit të Kelmendit ,të cilët u zunë robër prej Pashait, Hodoverd, u shpërngulën me dhunë dhe u vendosën në rrafshnaltën e krahinës së Peshterit, përkatësisht në Rugovë, Rozhajë, Tutin dhe Novi Pazar, ku figuronin 251 familje, përkatësisht me 1987 anëtarë.<sup>390</sup> Kurse vetëm në Rugovë kishte 8 familje me 50 besimtarë.<sup>391</sup>

Me këtë, rast arqipeshkëvi Zmajeviq, konstatonte se: “Kelmendasit iu larguan për një kohë të shkurtër rrezikut të turqizimit.” Mirëpo, “ata përballonin me vështirësi të mëdha mënyrën e re të jetesës, veçanërisht kontrollin e përhershëm të pushtetit turk, rrëfen arqipeshkëvi.”<sup>392</sup> Meqenëse disa familje ishin kthyer në Malësi, në

<sup>389</sup> Frok ZEFIQ, *Shqiptarët Kelmendas në Hrtkovac e Nikinc (1737-1997)*, Bashkësia Shqiptare në Republikën e Kroacisë, Zagreb, 1997, f.32-36.

<sup>390</sup> Jovan RADONIĆ, *Rimska Kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd, 1950, f. 514; P. BARTL, *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert*: Albanische Forschungen, band, 15, vol I, dok. 45, botua. Otto Harrassowitz. Wiesbaden, 1975, f. 139, 164.

<sup>391</sup> Peter Bartl, *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert*: Albanische Forschungen, band, 15, vol I, dok. 45, botua. Otto Harrassowitz. Wiesbaden, 1975, f. 136.

<sup>392</sup> J. RADONIĆ, vep. e cit., f. 515.

Peshter kishin mbetur 127 familje. Disa prej atyre me këtë rast ishin vendosur në grykën e Rugovës,<sup>393</sup> ku në vitin 1703, figurojnë se janë 8 familje me 50 banorë.<sup>394</sup>

Arsyen e shpërnguljes së Kelmendasve e vërteton edhe arqipeshkvi i Shkupit, Pjetër Karaxhiqi (Karragaqi) (1702-1727) në relacionin e tij dërguar Kongregacionit për Përhapjen e Fesë, më 20 maj të vitit 1706. Karaxhiqi, rrëfen për Kelmendasit, se për ta kujdesoheshin dy françeskanë të cilët financiarisht i mban Kongregacioni për Përhapjen e Fesë me nga 20 skuda vjetore. “*Ata nuk kanë Kishë, kurse mesha celebrrohet nëpër shtëpia dhe në të ftohtë, nën qiellin e hapur. Banesa famullitare shërben njëkohësisht edhe si Kishë*”.<sup>395</sup>

Në relacionin e mëvonshëm të 4 gushtit të vitit 1719, arqipeshkvi Karaxhiqi, flet edhe për të ardhurit e rinj, nga fiset e tjera. Ai, në mes tjerash, shkruan: “Në rrafshnaltën e Peshterit ka shumë fshatra, në disa prej tyre jetojnë kelmendasit, ata kanë dy priftërinj misionarë: frat Antonin nga Montemura dhe frat, Jozefin nga Pedana. Këta marrin 25 skuda nga Kongregacioni në vit, për të mbajtur veten. Ky mision ka 300 shtëpi katolike dhe mbi 2.000 frymë.” Për Plavën, Rugovën dhe fshatrat përreth, arqipeshkvi thotë se “janë mbi 500 frymë.”<sup>396</sup>

Nga relacioni i mëvonshëm i arqipeshkvit të Shkupit, Pjetër Karaxhiqit, nga data 24 prill e vitit 1722, drejtuar Kongregacionit për Përhapjen e Fesë, në udhëheqjen e misionit vërehet një përforsim i ri. Thuhet se në fshatrat Rugovë e Plavë, në muajin shtator të vitit 1721, kanë ardhur dy misionarë, atë Karlo nga Caprina dhe atë Ludovigo, gjithashtu nga Caprina. Atë vit ishin krezmuar rreth 200 persona.<sup>397</sup>

Në relacionin e arqipeshkvit të ri të Shkupit, Mëhill Suma (1728-1743), dt. 8 tetor të vitit 1729, kuptojmë së në Rugovë është shtuar numri i popullatës. Ai rrëfen së në Pejë veprojnë meshtarët françeskanë nga më

<sup>393</sup> J. RADONIĆ, , vep. e cit., f. 515.

<sup>394</sup> Peter BARTL, *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert*: Albanische Forschungen, band, 15, vol I, dok. 45, izd. Otto Harrassowitz. Wiesbaden, 1975, f. 136.

<sup>395</sup> Marko JAČOV, *Spisi tajnog Vatikanskog arhiva od XVI – XVIII veka*, dok. 118.:SANU, Beograd, 1983, dok. 163, f. 184.

<sup>396</sup> Marko JAČOV, *Le Missioni Cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vol. I, Citta del Vaticano, 1992, dok. 216, f. 252.

<sup>397</sup> M. JAČOV, *Le Missioni Cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vol. I, dok. 216, f. 252.

superiori atë Frano nga Milano, i cili me duar të veta e ndërtoi banesën për banimin e klerikëve në fshatin Rugovë.<sup>398</sup> Suma në relacionin e dt. 1 gusht të vitit 1732, shënon se në misionin e Rugovës në atë vit kishte 800 katolikë, ndërsa në Peshter 2.500 frymë katolike.<sup>399</sup>

Pas, Sumës i cili për shkak të dhunës turke shpërngulet së bashku me popull në Srijem, arqipeshkvi i Shkupit, Gjon Pagëzuesi Nikolloviq – Kazazi (1743-1752) në relacionin e tij të 3 dhjetorit të vitit 1741, na jep një informacion të ri duke na njoftuar së Rugova nga një mision i thjeshtë që, deri atëherë administrohet nga qendra misionare e Pejës dhe ajo e Peshterit, do ngrihej në rangun e një administrate kishtare më vete, (famullie) e populluar me fisin e Kelmendasve.<sup>400</sup> Po kështu Kazazi në relacionin më 24 shkurt të vitit 1756, flet se në Rugovë që gjendet mbi Pejë si meshtar është duke shërbyer një françeskan shqiptar, Atë, Gjon Nika i cili kishte ndërtuar një Kishë të bukur, të vogël dhe një kasolle të varfër të priftërinjve.<sup>401</sup> Më pas kemi famullitarë, Dom Gjon Llogorecin 1760-1762; dom Amroz Bosko, 1762-1765; dom Pal Zogaj, 1765-1769, të cilët shprehen së në Rugovë kishte vetëm 20 shtëpi katolike dhe 800 të tjerat ishin islamizuar, ose kaluar në laramanizëm. Gjithashtu Gjon Llogoreci thotë së në Peshtër që nga viti 1746 nuk kishte më të besimit katolik.<sup>402</sup> Pas Zogajt i cili me 25 nëntor të vitit 1771, si hartues i një gramatike në shqip, gjendej veç në Osjek të Kelmendasit në Srijem,<sup>403</sup> famullitarët e Rugovës rreshtohen: atë Zef Urbani, 1773, nga Misioni i Kastratit dhe atë Bonaventura Pasi, 1774-1781, po nga i njëjti Mision.<sup>404</sup> Më pas kemi dom Ndre Krasniqin 1781-1787, i cili ishte famullitar në Pejë dhe i fundit dom Zef Berisha, 1783-1784.<sup>405</sup> Përndryshe kujdesin për Rugovën gjithmonë e ka mbajtur famullia e Pejës e cila, sipas arqipeshkvit Karaxhiqi, e kishte Kishën e ndërtuar që në vitin 1719,

<sup>398</sup> J. RADONIĆ, vep. e cit., f. 559.

<sup>399</sup> J. RADONIĆ, vep. e cit., f. 560.

<sup>400</sup> J. RADONIĆ, vep. e cit., f. 572.

<sup>401</sup> Frok ZEFIQ, *Shqiptarët Kelmendas në Hrtkovac e Nikinc (1737-1997)*, Bashkësia Shqiptare në Republikën e Kroacisë, Zagreb, 1997, f. 65.

<sup>402</sup> Frok ZEFIQ, vepër e cituar, f. 65-66.

<sup>403</sup> Vepër e cituar, f. 103.

<sup>404</sup> Vepër e cituar, f. 66.

<sup>405</sup> Vepër e cituar, f. 67.

kushtuar Shën Katarinës.<sup>406</sup> Më vonë në vitin 1722, arqipeshkvi lajmëron së Kisha e Pejës ishte shkatërruar nga Turqit dhe me gurët e saj kishin ndërtuar Kullën e sahatit për qytetin.<sup>407</sup>

### Islamizimi i rugovasve si sprovë e patriotizmit

Pushteti turk, për ta mbajtur nën zaptim popullatën e nënshtruar, pos dhunës së ushtruar në forma të ndryshme, nga likuidimi fizik deri te varfëria ekonomike, jeta sociale e politike, ndalimit të shkollimit në gjuhën shqipe, pushteti ka arritur ta kthejë popullatën nga besimi katolik në besimin islam.<sup>408</sup> Imzot Pjetër Karaxhiqi, kishte njoftuar më dt. 24. IV, të vitit 1722, së në Pejë, turqit e kishin shndërruar në objekt publik, Kishën e Shën Katarinës dhe kambanarin në kullë sahati për qytetin.<sup>409</sup> Për peshën e rëndë ngarkuar rugovasve, flet Arqipeshkvi i Shkupit, Mati Mazreku(1758-1807) në relacionin e tij të vitit 1764, ku flet për jetën e vështirë të popullatës dhe ku për shkak jetës së rrezikshme, asnjë meshtar nuk dëshiron për të shërbyer në këtë famulli<sup>410</sup> për shkak të kërcënimeve turke. Në relacionet e mëvonshme, flitet mbi një kalim më të intensifikuar të katolikëve të Plavës dhe fshatrave përreth në islam. Shkodrani dom Gjon Logoreci (1751 -1780),relacioni i tij për Rugovën, 12 qershor 1760, dërguar arqipeshkvit të Shkupit, Mati Mazrreku (1758-1807), në mes tjerash, thotë se në Rugovë numri i katolikëve është duke u zvogëluar çdo ditë, diçka pak katolikë ka në Peshter, Guci dhe Plavë, të cilët relatori nuk mund t'i vizitojë për shkak të turqve.<sup>411</sup>

<sup>406</sup> Frok ZEFI , *Arqipeshkvija Shkup-Prizren, në shek. XVIII.* , Bashkësia Shqiptare në Prefekturën e Osjekut, Osijek, 2000, f.182-183.

<sup>407</sup> Frok ZEFI , vepër e cituar, f.183.

<sup>408</sup> Mirko BAJRAKTAREVIČ , *Rugova, Naselja i poreklo Stanovništva* , knjiga 36, Srpska Akademia Nauka i Umjetnosti, Beograd, 1960, f. 174.

<sup>409</sup> Marko JAČOV, *Spisi tajnog Vatikanskog arhiva od XVI – XVIII veka*, dok. 118.:SANU, Beograd, 1983, f. 252

<sup>410</sup> Gjergj GASHI, *Vatikani dhe Arbëria. 1700- 1922*, Onufri, Tiranë, 1998, dok. 42, f. 73.

<sup>411</sup> Jovan RADONIĆ, *Rimska Kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd, 1950, f. 656-657.

Pesë vjet më vonë në këtë vend malor, të lënë pas dore, do të vinte misionari i ri bursisti më i parë i Propaganda Fides, Dom Pal Zogaj (Shogani) nga Brija, përkatësisht Zogajt e Bytyqit krahina e Gjakovës.<sup>412</sup>

Ai, në relacionin e tij të dt. 20. VIII, 1767, shkruan se në Rugovë kanë mbetur vetëm 12 shtëpi katolike, pjesa e tjetër janë katolik të fshehur (laraman)<sup>413</sup> dhe Rugova në këtë kohë ishte e copëtuar në tri principata: Arbëri, Mali i Zi dhe Serbi. Në relacionin e tij të disa viteve më parë (1765), Zogaj ishte shprehur së në Rugovën e administruar nga pashai i Pejës ka pasur 10 fshatra me afro 300 besimtarë katolikë, të cilët kanë marrë pjesë në sakramende të shenjta, dhe ku janë përjashtuar ata me emra turq, përkatësisht laramanë të cilët ishin në shërbim të pashait të Pejës.<sup>414</sup>

Për arsye të kushteve jashtëzakonisht të vështira dhe kthimit në islam, ai e lëshon famullinë e Rugovës dhe shkon në Srijem të Sllavonisë, në Nikinci, Hrtkovac për t'u shërbyer kelmendasve të shpërngulur atje. Për fenomenin e laramanizmit në Rugovë, flet eprori i Misionit të Kastratit, Atë Bonaventura i cili shprehet se në vitin 1779, në Rugovë nuk ka më katolikë publikë.<sup>415</sup> Në Rugovë, ku pos fisit më të vjetër të Kelmendit në gjirin e saj ka edhe disa lagje nga fiset e Shkrelit, Kastratit e Shalës.<sup>416</sup> Studiuesi serb Teodor Stankoviq, në një shkrim të vitit 1910, shprehet se, në Rugovë ka rreth 800 shtëpi, sa kishte shënuar, edhe Don Pal Zogaj, dhe së islamizimi i familjeve të fundit duhet të këtë ndodhur në vitin 1840, të ndikuara nga mulla Sylë Rugova.<sup>417</sup>

Islamizimi i popullatës, nënkuptonte nënshtrimin e plotë të tyre nën qeverisjen turke. Tjetërsimi i dokeve dhe zakoneve, rregullimit

<sup>412</sup> Frok ZEFI, *Arqipeshkvija Shkup-Prizren, në shek. XVIII. të*, Bashkësia Shqiptare në Prefekturën e Osjekut, Osijek, 2000, f.85.

<sup>413</sup> Jovan RADONIĆ, *Rimska Kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd, 1950, f. 657.

<sup>414</sup> Jovan RADONIĆ, vep. Cit., f. 657.

<sup>415</sup> Gjergj GASHI, *Vatikani dhe Arberia. 1700- 1922*, Onufri, Tiranë, 1998, dok. 68, f.76.

<sup>416</sup> Mirko BAJRAKTAREVIĆ, *Rugova, Naselja i poreklo Stanovništva*, knjiga 36, Srpska Akademia Nauka i Umjetnosti, Beograd, 1960, f. 176; Mark KRASNIQI, *Popullsia e Rugovës*, në: *Rugova, Monografi, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës*, libri, 6, Prishtinë, 1987, f. 37.

<sup>417</sup> Gasper GJINI, *Skopska – prizrenska biskupija kroz stoljeća*, Drita, Ferizaj dhe Kršćanska Sadašnjost, Zagreb, 1986, f. 136; Ejup Bajraktarević, *Enički proces i etnička struktura stanovništva Novog Pazara*, Srpska Akademia Nauka i Umjetnosti, Beograd, 1979, f.209-210.

shoqëror, veshjes, ndryshimi i arkitekturës, emrave, riteve fetare, shkollimit dhe përpjeka për tjetërsimin e nacionalitetit. Të gjitha këto kishin si qellim, kthimin e rugovasve, nga mentaliteti perëndimor në atë islamik lindor. Kuptohet, se rugovasit pos pranimit të islamit, falë traditës atdhetare të trashëguar brez pas brezi, nuk pranuan të jenë të nënshtruarit e Stambollit, por krah për krah me krahinat e tjera, luftuan vazhdimisht për çlirimin e trojeve shqiptare nga hordhitë turke. Kalimi në besimin islam i shqiptarëve si rrjedhojë, pati pasoja të shumëfishta në jetën politike, ekonomike, shoqërore, fetare dhe kulturore të popullit shqiptar. Islamizimi nuk ndodhi me popujt ortodoks edhe pse gjendeshin në forntin e parë, për shkak të marreveshtjes dypalshe, nënshkruar mes Perandorisë Osmane e Patriarkut Genadin të nënshkruar në vitin 1453, në Kostantinopojë.

Bota perëndimore, shqiptarët nuk i pranonte si komb më vete, por sipas prezantimit të bërë nga Perandoria Osmane, ku shqiptarët e islamizuar i identifikonin si turq, ata ortodoks si grek dhe katolikët si latin.<sup>418</sup> Rezultati kryesor i këtij procesi ishte fakti se, në fushën politike, Fuqitë e Mëdha, duke na konsideruar 70 % në masë të islamizuar, në Kongresin e Berlinit të vitit 1878, dhe Konferencën e Londrës 1913, pa skrupull u shpërndanë fqinjve trojet shqiptare.<sup>419</sup>

### **Shqiptarët në përballje me Kishën Ortodokse, nacionaliste serbo-malazeze**

Kisha ortodokse Serbe si kishë nacionale, ka qenë gjithmonë e lidhur ngusht me pushtetin e popullit serb. Dëshmia më e mirë rreth këtij argumenti, është libri, Mihajlo I. Popoviq, “Roli historik i Kishës Serbe në ruajtjen e nacionalitetit dhe formimin e shtetit”, Beograd, 1933,<sup>420</sup> si dhe shumë botime të tjera.

<sup>418</sup> Stavro SKENDO, *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*, Phonix, Shtëpia e librit dhe komunikimit, mendimi shqiptar nr. 6, Tiranë, 2000, f. 130; Petrika THËNGJILLI, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit, (1506-1839), fusha fetare*, botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 328; *Historia e Popullit Shqiptar*, shkollat e mesme, Tiranë 1994, f. 88.

<sup>419</sup>Eqrem ZENELAJ, *Çështja Shqiptare, nga këndvështrimi i diplomacisë dhe gjeopolitikës së Austro-Hungarisë, (1699-1918)*, Faik, Konica, Prishtinë, 2010, f. 187.

<sup>420</sup> Mihajlo POPOVIQ, *Istorijska uloga Srpske Crkve u očuvanju narodnosti i stvaranju države*, Beograd, 1933.

### Kush ishte Kisha Serbe?

Autonominë e vet, Kisha ortodokse Serbe e fitoi në kohën e lulëzimit të shtetit serb, në vitin 1219, me ndërmarrjen më së shumti të të birit të Stefan Nemanjës i cili deri në moshën 32-vjeçare ishte katolik, e më vonë Shën Savës me qendër në Rash-Novı Pazar dhe më vonë Zhiqa.<sup>421</sup> Teksa në kohën e sundimit të mbretit Stefan Dushanit pushtues, (1331-1355), i cili e kishte shpallur veten mbret i serbëve, grekëve dhe mbarë Rumelisë,<sup>422</sup> qendra e Arqidioqezës Ortodokse serbe, në vitin 1346, nga Zhiqa kishte kaluar në Pejë, duke e ngritur atë në rangun e Patrikanës. Pas pushtimeve turke, roli i saj qe ndërprerë në vitin 1459, duke iu bashkuar arkidioqezës së Ohrit, për t'u ripërtërirë për shkak të rrethanave politike në vitin 1557, në cilësinë e prijësit fetar dhe civil të popullit serb në të gjitha territoret, të cilat ata i kishin pushtuar, madje deri në Hungari.<sup>423</sup> Pasi juridiksioni i Papës nuk varej nga sulltani, Patriarku i Pejës orvatej që të gjithë sllavët e krishterë të fesë sllavoortodokse dhe shqiptarët në Perandorinë Turke, t'i përfshinte nën juridiksionin e vet.<sup>424</sup>

Duke gjetur mbështetje te turqit, kleri sllavoortodokës i bëri përdhunë edhe katolikët që t'u paguajnë taksa edhe patriarkaleve vendorë.<sup>425</sup> Qendra kryesore e propagandës sllavoortodokse për Shqipërinë Veriore ishte Patrikana e Pejës, kurse për Shqipërinë e Mesme dhe atë Jugore, ishin Arqidioqeza e Ohrit dhe Janinës. Patriarkana e Pejës, duke qenë vazhdimisht nën trysninë e Perandorisë së Austrisë, në vitin 1788, disa mendojnë edhe më parë në vitin 1776, zyrtarisht përsëri u

<sup>421</sup>Milan ŠUFFLAY, *Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damm*, Illyrisch-Albanische Forschungen, vol I, München und Leipzig, 1916, f. 207, 229; Novak RAŽNATOVIĆ, *O crnogorsko-primorskoj mitropoliji kao političkom faktoru u Istoriji Crne Gore: Prošlost Crne Gore, kao predmet naučnog istraživanja i obrade*, br. 7, CANU, Titograd, 1987, f. 307.

<sup>422</sup>Nikë dom UKGJINI, *Kisha katolike në Trevat Shqiptare (Nga shek., XI-deri sot)*, Qendra botuese, Shoqata e Jezuitëve, Tiranë, 2016, f. 56.

<sup>423</sup>Dragoslav ŽIVKOVIĆ, *Istorija Crnogorskog naroda*, tom II, Cetinje, 1992., f. 90.

<sup>424</sup>Dominik MANDIĆ, *Bosna i Hercegovina*, sv. III, Rim, 1967, f. 369.

<sup>425</sup>Geog STADTMÜLLER, *Die Islamisierung bei den Albanern: Jahrbücher für Geschichte Osteuropas*, N.F. 3, München 1955, f. 427.

suprimua, duke i kaluar kompetencat, në Patriarkanën e Kostandinopojës,<sup>426</sup> dhe si metropoli pushteti kishte

kaluar në Sremski Karlovac dhe nga viti 1879 në Beograd. Peja tashmë kishte rënë në rangun në një Eparki (dioqezë) ortodokse serbe e lidhur me metropolin e Cetinës duke ruajtur njëherësh edhe rolin e manastirit.

### Eparkia e Pejës dhe dhuna mbi shqiptarët

Eparkia (dioqeza) ortodokse e Pejës së bashku me Eparkinë e Prizrenit e të Shkupit, të cilat funksiononin brenda Vilajetit të Kosovës, të lidhura ngusht me Metropolinë ortodokse të Cetinës, të nxitura nga politika greke e serbo-malazeze, kanë qenë vazhdimisht aktive në përkrahjen e politikës së kohës për copëtimin e trojeve shqiptare, si në Konferencën e Berlinit 1878, po ashtu në atë të Londrës, në vitin 1913, kur flitej për mundësinë e shqyrtimit të ndërrimit të kufijve territorialë në Ballkan.<sup>427</sup> Për këtë arsye edhe në të kaluarën, ka pasur vazhdimisht fërkime mes Kishës Katolike dhe asaj Ortodokse, si dhe për shkaqe të koncepteve të kundërta dogmatike fetare, politike e nacionale.

Këto kundërshtime kuptohen qartë nga mëkëmbësi i Arqipeshkvisë së Shkupit, Dom Gjon Logoreci me banim në Pejë, në relacionin e tij të 12 Shkurtit 1760, konstaton se Patriarkana e Pejës, duke bërë pazare me Stambollin, është duke punuar në dëmin e shqiptarëve katolikë. Ajo, vazhdon Logoreci, ka një urrejtje më të madhe ndaj katolikëve sesa ndaj turqve.<sup>428</sup> Po kështu Logoreci edhe në letrën më 25 qershor 1775, shpreh ankesat e veta për patriarkun e Pejës.<sup>429</sup>

Po të njëjtin shqetësim e ka shprehur edhe Kryeipeshkvi i Shkupit, Imzot Mati Mazreku, më 20 gusht 1774, i cili duke u ankuar te Propaganda Fide në Romë, për Kishën Ortodokse serbe, thotë se, ai nuk mund t'i ketë mbi kokë dy zotërij: turkun dhe Patriarkun e Pejës, .<sup>430</sup>

<sup>426</sup> Jovan RADONIĆ, *Rimska Kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd, 1950, f. 664-666.

<sup>427</sup> Noel Malcom, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 333.

<sup>428</sup> Jovan RADONIĆ, *Rimska Kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd, 1950, f. 656-657.

<sup>429</sup> Jovan RADONIĆ, vepër e cituar, f. 676,

<sup>430</sup> Jovan RADONIĆ, vepër e cituar, f. 675.

Mazreku në një relacion tjetër më 20. II. 1779, dërguar Propaganda Fides, shkruan për kërcënimet dhe presionet që vazhdimisht i bën Patriarku i Pejës, ndaj katolikëve, duke tentuar që ata t'i përfitojë me forcë për vete.<sup>431</sup> Më 5 mars, 1790, Mazreku, në një letër zyrtare, shprehet së pas këtij presioni nga Kisha Ortodokse dhe kërcënimeve për ta likuiduar atë, qëndron politika, serbo-greke dhe ajo ruse.<sup>432</sup> Janë shënuar edhe raste të tjera të kësaj natyre.

Kisha Ortodokse serbo-malazeze po të njëjtën politikë, madje edhe më radikale, e ka ndjekur edhe në vitet 1910 e në vazhdim. Kjo u tregua qartë me rastin e vizitës së Sulltan Mehmetit V, në Prishtinë, më 15 qershor 1911, ku u prit nga një masë e madhe serbësh, e kori i seminarit të Kishës ortodokse serbe i këndoi atij këngë turke, ndërsa në anën tjetër shqiptarët e kishin bojkotuar këtë pritje.<sup>433</sup>

Serbia në prag të mbajtjes së Konferencës së Londrës, dhjetor, 1912- gusht 1913, kërkonte gjithë trevën e Kosovës, tokat shqiptare që sot ndodhen në Maqedoni dhe viset e tjera të Shqipërisë së Veriut si dhe daljen nëpërmjet Mirditës për në det në Durrës. Mali i Zi ishte për aneksimin e Shkodrës dhe deri në lumin Mat dhe Greqia pjesët e jugut të Shqipërisë.

Për ta vendosur Konferencën e Londrës, e cila po zhvillonte bisedimet për rishqyrtimin e kufijve, para faktit të kryer, Serbia e Mali i Zi, nën pretekstin për një luftë kundër turqve, dhe kundërshtimit të politikës Austro-hungareze në Ballkan,<sup>434</sup> filloi shtetrrëhimin ndaj Shqipërisë, dhe pastrimin etnik të popullatës nga trojet shqiptare të mbetura jashtë nga Konferenca e mëparshme e Berlinit. Më këtë rast, nga Serbia e Mali i Zi, e ndihmuar nga Kisha Ortodokse serbe, u ndoq politika gjenocidale dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi, gjë që ndikuan që trojet shqiptare të pushtuara të shkatërroheshin pothuajse tërësisht.<sup>435</sup> Arsyeja imediate e të gjitha masave barbare e kryer nga serbët e malazezët ndaj shqiptarëve ishte, ndërrimi i statistikës së

<sup>431</sup> Gjergj GASHI, *Vatikani dhe Arbëria. 1700- 1922*, Onufri, Tiranë, 1998, f.76.

<sup>432</sup> Jovan RADONIĆ, *Rimska Kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd, 1950, f. 675.

<sup>433</sup> Noel MALCOM, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 319.

<sup>434</sup> Dimitrije POPOVIĆ, *Borba za narodno Ujedinjenje, 1908-1914, Srpski Narod u XIX veku, knj.7, Beograd, 1936. f. 77.*

<sup>435</sup> Noel MALCOM, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 332.

popullatës, si dhe përforcimi i veprimtarisë diplomatike të Qeverisë serbe dhe asaj malazeze që pretendonin se kishin të drejtë t'i përfshinin këto troje të pushtuara në shtete të tyre.<sup>436</sup> Po pretendimet e tyre a ishin të drejta, për pushtimin e Kosovës dhe trojet në Maqedoni? Dokumentet historike të huaja na flasin se para ardhjes së osmanëve, trevat tona u pushtuan nga venecianët e serbët, grekët, bullgarët, dhe pastaj në shek.. XV, u pushtuan nga turqit osmanli. Ndërkaq para luftërave Ballkanike, statistikat përsëri flasin në favorin tonë. Do marrim si shembull vetëm gjendjen e popullatës në Pejë. Statistika turke e vitit 1908-1909, tregon së në Pejë, kishte 72.5% shqiptarë dhe serbë vetëm 19%. Ndërsa ajo Austro-Hungareze, e vitit 1916, eidenton së në Pejë kishte 83.1 % shqiptarë, dhe vetëm 11.9% serb.<sup>437</sup> Po e njëjta situatë përsëritet edhe në qytetet e tjera.

Në momente kur Turqia ishte duke u shporrur nga Ballkani, në prill të vitit 1912, kishin shpërthyer kryengritjet shqiptare në rrethinë të Gjakovës e Pejës. Sipas konsullit të Francës në Shkup, kryengritje me 3 gusht 1912, kishin shpërthye edhe në Prishtinë, në Prizren, në Shkup.<sup>438</sup> Me 13 tetor, edhe Serbia me aleatët e saj, Bullgarinë, Greqinë e Malin e Zi,<sup>439</sup> i kishte shpallur luftë Turqisë, duke hyrë në Kosovë dhe në territorin e Shqipërisë për kthimin e Serbisë së vjetër.<sup>440</sup> Krajl Nikolla, në gusht, 1912, erdhi t'i përtërinte lidhjet e tij të mëparshme me fiset shqiptare katolike në Veri të Shqipërisë me qëllim të pushtimit të Shkodrës.<sup>441</sup> Mali i Zi, me këtë rast, për t'ua mjegulluar mendjen malësorëve të Veriut dhe për t'i bindur se do të luftonte për çlirimin e Veriut nga Turqit, më 8 tetor 2012, i shpalli zyrtarisht luftë Turqisë.<sup>442</sup>

<sup>436</sup> Noel MALCOM, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 332.

<sup>437</sup> *Shqipnia përpara Konferencës së Paqes*, ( Paris 1919) Ble i Parë, Romë, 1919.f. 35-37.

<sup>438</sup> Dimitrije POPOVIĆ , *Borba za narodno Ujedinjenje, 1908-1914, Srpski Narod u XIX veku, knj.7, Beograd, 1936*, f. 83.

<sup>439</sup> Dimitrije POPOVIĆ, vepër e cituar, f. 73; Jagosh JOVANOVIQ, *Stvaranje Crnogorske Države*, Narodna Knjiga, Cetinje, 1945, f.400.

<sup>440</sup> Noel MALCOM, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 327.

<sup>441</sup> Noel MALCOM, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 325.

<sup>442</sup> Dimitrije POPOVIĆ, *Borba za narodno Ujedinjenje, 1908-1914, Srpski Narod u XIX veku, knj.7, Beograd, 1936*, f. 84.

### Kthimi fetar i shqiptarëve me dhunë në fenë ortodokse

Mali i Zi, për të arritur realizimin e qëllimeve të veta, si: nënshtrimin, shpërnguljen e shqiptarëve, pastrimin etnik dhe kolonizimin, në Pejë, në Rugovë e në vendet përreth, përdori masa të ndryshme shtrengimi: dhunën, masakrimin, mbjelljen e tmerrit kudo, thyerjen e moralit të shqiptarëve, të cilët edhe kështu nuk ishin të organizuar dhe të bashkuar në mbrojtjen e trojeve të tyre.

Aksioni ushtarak, kishte filluar nga Plava, Gucia, Rozhaja, për ta vazhduar në Rugovë si pararojë, e qytetit të Pejës. Në Rugovë që në fillim u dogjën 14 shtëpi. Më 26 tetor, 1912, ushtria malazeze në krye me gjeneralin, Janko Vukotiq, hyri në Stupeq të Madh e të Vogël dhe në Rekë të Allagës duke torturuar e përgjakur popullatën dhe një pjesë duke e shpërngulur për në Mal të Zi. Me këtë rast nuk u kursye as Zhuj Veseli, nga vëllazëria Nikçi, rojtsi i brez pas brezi i Patrikanës së Pejës plot 300 vjet<sup>443</sup> dhe Manastirit të Deviqit i cili qe syrgjynosur në Nikshiq. Kështu u hap rruga për të marshuar drejt Pejës e cila kishte mbetur pa udhëhqës, sepse nga frika për jetën, Zenel Begu kishte ikur për në Stamboll, dhe Jashar Pasha u ishte dorëzuar serbëve në Mitrovicë. Dhe më 30 dhjetor, 1912, ushtria malazeze kishte hyrë në Pejë, duke e ngritur flamurin e vet në Patriarkanë, ku ishte vendosur shtabi i ushtarak, <sup>444</sup> dhe ngriti organet ushtarake e administrative në krye me gjykatësin, Jovan Plamenac.<sup>445</sup>

Pas vendosjes së sistemit ushtarako-policor të administrimit, në shtator 1912, filloi fushata e mbledhjes së të gjitha llojeve të armëve, në qytete e në fshatra, të cilat që në vitin 1897, i kishte shpërndarë Austro-Hungaria për kryengritje ndaj turqve.<sup>446</sup> Gjatë këtyre aksioneve, pati bastisje e djegie e plaçkitje të shtëpive. Pati të kërcënuar, të vrarë, të masakruar, e të torturuar dhe të shpërngulur. Sipas, prof. Zekeria Canës,

<sup>443</sup> Mirko BAJRAKTAREVIČ, *Rugova, Naselja i poreklo Stanovništva*, knjiga 36, Srpska Akademia Nauka i Umjetnosti, Beograd, 1960, f. 212; Mark KRASNIQI, *Popullsia e Rugovës, në: Rugova*, Monografi, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, libri, 6, Prishtinë, 1987, f. 38-39.

<sup>444</sup> Zekeria CANA, *Gjenocidi i Malit të Zi, mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, f. 26.

<sup>445</sup> Zef Mark HARAPI, *Ditt e Trishtimit N'Pejë e Nder Rrethe, 1912-1913*, (Redaktor Dom Nikë Ukgjini), Dukagjini, Pejë, 2004, f. 71.

<sup>446</sup> Dimitrije POPOVIĆ, *Borba za narodno Ujedinjenje, 1908-1914, Srpski Narod u XIX veku*, knj.7, Beograd, 1936, f. 77, 78.

torturime e kërcënime, tmerri, në Pejë e në Rugovë pati pa fund, si në mbledhjen e armëve, po ashtu në momente të presionit për të kaluar nga feja myslimane e ajo katolike në fenë ortodokse serbe e malazeze. Por sipas burimeve malazeze për numrin e viktimave të masakrës së Rugovës, në krahasim me vendet e tjera, janë më të pakta.<sup>447</sup> Sipas Canës në Pejë ishin dy viktima, kurse në Rugovë, 37 persona.<sup>448</sup> Por, dëshmitari i ngjarjeve të vitit 1912-1913, që ishte mësues i shqipes në Pejë, Zef Mark Harapi, shprehet : “N’nji javë Qeverisja pati vrrarë 113 veç e pse nuk ndigiuene me u ba shkje; vriteshin n’ditë e n’natë ka pesmdhet e nizet vetë.”<sup>449</sup> Dhe vazhdon Zef Harapi se në Rugovë, për shkak të armëve kanë mbërri me vra 11 persona vetëm prej një familje, duke e lënë shtëpinë vetëm në një burrë 60-vjeçar.<sup>450</sup> Rrëqethës është dhe momenti i një fëmije 7-vjeçar në Rugovë, rrëfimin që Harapi e kishte marrë prej një ushtari të penduar malazias, “ Para se t’na jepej urdhni prej Kapidanit një fmii nja 7 vjetësh u ul n’giuj e m’u lut me e fal, m’lshonte bee: paash kryet e Krajl Nikollës- m’tha-mos m’vra se po bahem shkjaa, por unë i ndigiova të parët e e vrava.”<sup>451</sup> Raste të ngjashme ka dhe në të gjitha rrethet e tjera që duhet zbuluar nëpër arkiva të ndryshme.

Se çfarë pësoi popullsia shqiptare e Rugovës nga ushtria malazeze, ilustrohet më së miri, nga biseda që londinezja Edith Durham, në fillim të vitit 1913, kishte zhvilluar në Cetinë me gjeneralin Janko Vukotiq, i cili shprehej se ne i mposhtëm dhe i vramë të gjithë burrat e Rugovës.<sup>452</sup>

<sup>447</sup> Zekeria CANA, *Gjenocidi i Malit të Zi, mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, f. 26.

<sup>448</sup> Zekeria CANA, vepër e cituar, f. 359-363.

<sup>449</sup> Zef Mark HARAPI, *Ditët e Trishtimit në Pejë e ndër rrethe, 1912-1913*, (Redaktor Dom Nikë Ukgjini), Dukagjini, Pejë, 2004, f. 82.

<sup>450</sup> Zef Mark HARAPI, *Ditët e Trishtimit në Pejë e ndër rrethe, 1912-1913*, (Redaktor Dom Nikë Ukgjini), Dukagjini, Pejë, 2004, f. 82.

<sup>451</sup> Zef Mark HARAPI, vepër e cit., f. 83.

<sup>452</sup> Zekeria CANA, *Gjenocidi i Malit të Zi, mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, f. 26.

## Ndërrimi i besimit me dhunë, metodë mesjetare e Kishës Ortodokse

Ngjarja e cila shkaktoi habi në historinë e Evropës moderne, ishte ndërrimi i besimit të shqiptarëve me dhunë i iniciuar nga Kisha Ortodokse serbo-malazeze me qendër në Pejë, e filluar në mbarim të vitit 1912 e deri në fund të muajit mars të viti 1913.

Pushteti malazez që t' i realizonte aspiratat e veta, krahas aksionit për mbledhjen e armëve në popull, ndërmori aksionin, për ndërrimin e besimit nga ai mysliman e katolik në besimin ortodoks sllav, me anë të cilit do të sllavizonte shqiptarët.

Kisha ortodokse e mbështjellë me nacionalizëm të verbuar, bëri që në të gjitha viset e Dukagjinit, në Rugovë dhe në vende të tjera, ushtria dhe policia malazeze të detyronte me dhunë kalimin e popullsisë shqiptare myslimane e katolike në besimin ortodoks, që do të thoshte të sllavizoheshin. Të gjithë vëzhguesit e kohës flasin se nga frika dhe dhuna e ushtruar, shqiptarët pagëzoheshin duke marrë emra të rinj sllav dhe në krye u vinin "kopicën" malazeze si shenjë e dukshme nga jashtë.<sup>453</sup> Dëshmitari, Zef Mark Harapi, duke marrë rastin në Pejë dhe Rugovë, shprehet, se të gjithë ata që kundërshtonin pranimin e besimit ortodoks dhe sllavizimin u likuiduan para syve të popullit të grumbulluar në sheshe të caktuara të parapara për publikim e ngjarjeve.<sup>454</sup>

Nga sjelljet e brutalitetet e ushtrisë e policisë, në ndërrimin e besimit, të udhëhequr nga Savë Batarja (Lazarevqi), thuhet në dokumente se u persekutuan shumë njerëz, në Pejë si në fshatrat Haxhaj, Kuqishtë, etj., nga ku banorët kishin ikur në malësinë për t'u shpëtuar masakrave të pushtetit malazez. Lidhur me ritualet e pagëzimit të dhunshëm flet raporti i ministrit të brendshëm, Jovan Plamenac, dt. 21. XII. 1912, ku jep instruksionet për Manastirin e Pejës, se si duhet vepruar në këto raste.<sup>455</sup>, Në një dokument tjetër, dt. 18.III. 1913 Plamenac referon së puna po ecën mirë në Pejë e Gjakovë dhe shumë po paraqiten për t'u pagëzuar në

<sup>453</sup> Shukri RRAHIMI E kaluara historike e Rugovës, në: Rugova, Monografi, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, libri, 6, Prishtinë, 198, f. 24.

<sup>454</sup> Zef Mark HARAPI, *Ditt e Trishtimit Në Pejë e ndër rrethe, 1912-1913*, (Redaktor Dom Nikë Ukgjini), Dukagjini, Pejë, 2004, f.83.

<sup>455</sup> Zekeria CANA, *Gjenocidi i Malit të Zi, mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, f. 123.

ortodoksi.<sup>456</sup> Pastaj në dok. Nr. 1548, dt. 18. III, 1913, përgjegjësi Jovoviq, jep shënimin për 233 persona të pagëzuar në Pejë dhe ndërkohë kërkon që të këtë klerik ortodoks sa më shumë e mundësisht të atyre që e zotërojnë gjuhën shqipe për t'u marrë me këto rituale fetare.<sup>457</sup> Nga entuziazmi që kishte përfshirë përgjegjësin për rituale fetare në krahinën e Pejës, Jovoviq në një dok. 1544, dt 19. III. 1913 deklaronte së e terë komuna do të dëshironte të kalonte në Ortodoksi, dhe se duhet të vijnë në ndihmë edhe klerikët ortodoksë nga Berani.<sup>458</sup> Mark, Harapi, në kujtimet e veta tregon se nga Rugova i kishin larguar hoxhallarët dhe në vend të tyre i kishin dërguar tre priftërinj ortodoks të cilët i mblodhën myslimanët e një të shtunë e “i banë shkee”. Ata që nuk dëgjonin i torturonin nëpër burgje dhe duke i vrrarë. Madje i kanë vrrarë dhe fëmijët e vegjël në djep.<sup>459</sup> Raste të tilla kemi pa fund edhe në Plavë e Guci e Rozhajë.

Se kthimi i shqiptarëve në ortodoksi vërtetë kishte marr përmasa të gjera në pjesët e pushtuara vetëm nga malazezët, tregon Ministri i Punëve të Brendshme në Cetinë, Jovan Pllamenac, në telegramin, nr. 1658, dt. 21. III. 1913, ku shprehet se deri në këtë ditë, ishin pagëzuar rreth 5.000 shqiptarë. Protagonistë për kryerjen e pagëzimeve për Pejën me rrethina, ishte pop Maksimoviqi dhe igumeni, i Manastirit të Pejës, Janiqi, dhe komandanti Sava (Batarja) Lazareviq, kurse në Plavë e Guci pos komandantit Avro Cemit, ishte pop Gjorgje Shekullarac i cili duke u lavdëruar në një intervistë për gazetën “Politika”, shprehej se kanë kaluar në fe ortodokse 12.000 shqiptarë.<sup>460</sup>

### Qëndrimi i kishës ortodokse ndaj katolikëve

Kisha ortodokse e Pejës, kishte një qëndrim dinak ndaj kishës katolike në Pejë, pranë së cilës nga viti 1866, funksiononte shkolla shqipe, për shkak të frikës nga Austro-Hungaria që çështja të mos përfillet në Vjenë dhe Londër. Gjenerali, Janko Vukotiq, në letrën e tij,

<sup>456</sup> Zekeria CANA, vepër e cituar, f.153.

<sup>457</sup> Zekeria CANA, vepër e cituar, f. 153.

<sup>458</sup> Zekeria CANA, vepër e cituar, f. 155.

<sup>459</sup> Zef Mark HARAPI, *Ditt e Trishtimit N'Pejë e Nder Rrethe, 1912-1913*, (Redaktor Dom Nikë Ukgjini), Dukagjini, Pejë, 2004, f 83.

<sup>460</sup> Zekeria CANA, *Gjenocidi i Malit të Zi, mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913*, f. 33.

dt. 30. X. 2012, shkruar nga Patriarkana e Pejës, qorton mëkëmbësit e tij, të cilët kishin marrë në pyetje etërit françeskanë:<sup>461</sup> Atë Klement Miraj, Luigj Paliqi, David Pepa e Filip Paliqi, ku përgjegjës për katolikët e Pejës ishte, atë Klementi.<sup>462</sup> Vukotiq, në vazhdim është shprehur se, atyre, etërve françeskanë, nuk duhet t'u besohet. Por, etërit pa marrë parasysh nga mbikëqyrja që u bënë nga xhandarmeria malazeze, dilnin haptazi në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve të të dyja besimeve, çfarë më vonë reflektoi në përshkallëzimin e marrëdhënieve deri në konflikte të hapura me qeverinë e Mali të Zi.

Diplomatja Edith Durham, nga Cetina duke folur për kthimin e shqiptarëve myslimanë në ortodoksë, vazhdon, se nga Gjakova vijnë edhe lajme më të këqija, malazezët po përipiqeshin edhe katolikët t'i kthenin me forcë në besimin ortodoks.<sup>463</sup> Sllavo-ortodoksët nuk ndaluan me kaq, por ndërmorën edhe aksione të tjera shtypëse kundër shqiptarëve katolikë. Në mbrojtje të tyre më i zëshmi shfaqej famullitari i Gillogjanit në Lugun e Baranit, Atë Luigj Palaj i cili duke qëndruar në anën e besimtarëve pati deklaruar haptazi, se do t'i mbrojë edhe nëse koka do t'i shkonte. Qeveria e Malit të Zi, për ta frikësuar shpirtin e besimtarëve katolikë, më 7 mars të vitit 1913, në Janosh afër Gjakove, mbyti me bajoneta atdhetarin, bariun shpirtëror, atë Luigj Palaj<sup>464</sup> Gazeta "*Neue Frei Presse*" më 20 mars 1913, ndër të tjera shkruan për këtë ngjarje: "Pas sinjalit që dha prifti ortodoks, ushtarët iu hodhën françeskanit i shqyen habitin, ia hoqën nga trupi, dhe pastaj nisën ta godisnin me kondakët e pushkëve. Atë Luigji ra përdhe me disa brinjë dhe kocka të thyera...., Ata e pyetën priftin e plagosur rëndë, nëse ai tanimë do të vendoste për të ndërruar fenë e tij, prifti tundi kokën përsëri foli i qetë: nuk e braktis fenë time, nuk e thyej besën! Atë Luigjit iu vërvit një breshëri tjetër kondakësh. Një ushtar e shtyu fort bajonetën në mushkëritë e priftit. Jeta e tij mori fund."<sup>465</sup> Me këtë mbytje, sikur iu hapën shtigjet kishës nacionaliste ortodokse për ta vazhduar çfarë kishte ndërmend. Më

<sup>461</sup> Zekeria CANA, vepër e cituar, 107.

<sup>462</sup> Zef Mark HARAPI, *Ditt e Trishtimit n'Pejë e ndër rrethe, 1912-1913*, (Redaktor Dom Nikë Ukgjini), Dukagjini, Pejë, 2004, f. 65.

<sup>463</sup> Edit DURHAM, *Brenga e Ballkanit*, ribotim, Naum Veqilxaxhi, Tiranë, 1998, f. 282.

<sup>464</sup> Branko BABIĆ, *Politika Crne Gore u novo oslobođenim krajevima, 1912-1914*, Cetinje-Titograd, 1984, f. 216-218; Leo FREUNDLICH, *Albaniens Golgota*, Wien, 1913, f. 28-29.

<sup>465</sup> Leo FREUNDLICH, *Albaniens Golgota*, Wien, 1913, f. 28-29.

16 mars, 1913, u realizua plani i ripagëzimit të 530 katolikëve në besimin ortodoks sllav.<sup>466</sup> Kështu me bekimin e Kishës Ortodokse jashtë çdo mendjeje të kodeksit të krishterë, në vitin 1913, në Gjakovë me rrethina u bë ripagëzimi i dhunshëm i 1.200 katolikëve.<sup>467</sup> Nga ana tjetër në disa momente u tentua vrasja edhe e kryeipeshkvit të Shkupit, Imzot Lazër Mjedës,<sup>468</sup> i cili i mbante gjallë popullatën e Kosovës nëpërmjet diplomacisë dhe shkollave shqipe që funksionin nga koha e Imzot Dario Bucciarelit në vitin 1865: në Gjakovë, 1865, Pejë 1866, Zym 1880, Shkup 1880, etj.,<sup>469</sup> ku qeveria turke i mbyllte shpesh këto shkolla, por me ndërhyrjen e Austro-Hungarisë e cila i financonte shkollat, ato hapeshin përsëri.

Jehona për vrasjen e Atë Luigj Palajt dhe fenomeni i ripagëzimit të popullatës katolike u shpërndan në qarqet ndërkombëtare më 22. III, 1913 nëpërmjet Imzot Lazer Mjedës dhe legatës Austro-Hungareze në Cetinë e Vjenë.<sup>470</sup> Shkrimet e shtypit në botën perëndimore, nxitën zhvillimin e polemikës së organit zyrtar malazias, *Glas Crnogorca* dhe gazetës Ruse, *Rusko Slovo* që u pasuan me demarshet diplomatike të fuqive të mëdha dhe hapat energjikë të Austro-Hungarisë. Ajo i referohej së drejtës së protektoratit, mbi katolikët në Ballkan nga viti 1797 dhe 1837 për shqiptarët, si dhe duke iu referuar deklaratës së Kongresit të Berlinit,<sup>471</sup> me anë të së cilës në rast të cënimit të të drejtave fetare katolike ka të drejtën e intervenimit ushtarak.

Se këtejmi me notën që Vjena ia dorëzoi Cetinës, tërhiqte vërejtjen për indinjatën që kishte shkaktuar për vrasjen e Atë Palajt dhe në të njëjtën kohë kërkoi zhvillimin e hetimeve dhe dënimi për të gjithë

<sup>466</sup> Zekeria CANA, *Gjenocidi i Malit të Zi, mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, f. 149. dok. 132.

<sup>467</sup> Branko BABIĆ, *Politika Crne Gore u novo oslobođenim krajevima, 1912-1914.*, Cetinje-Titograd, 1984, f. 208.

<sup>468</sup> Zekeria CANA, *Gjenocidi i Malit të Zi, mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, f. 132.

<sup>469</sup> Gasper GJINI, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, “Drita”, Ferizaj, 1992. f., 184-185.

<sup>470</sup> Zekeria CANA, *Gjenocidi i Malit te Zi, mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, f. 41; Zef Mark HARAPI, *Ditt e Trishtimit N’Pejë e Nder Rrethe, 1912-1913*, (Redaktor Dom Nikë Ukgjini), Dukagjini, Pejë, 2004, f. 85.

<sup>471</sup> Nikë dom UKGJINI, *Kisha katolike në Trevat Shqiptare (Nga shek., XI-deri sot)*, Qendra botuese, Shoqata e Jezuitëve, Tiranë, 2016, f. 155.

aktorët e këtyre ngjarjeve. Po të njëjtën kohë kërkohet kthimi i katolikëve në besimin e mëparshëm, dhe lirinë fetare të të gjithëve. Pas presionit të bërë nga ndërkombëtarët qeveritë në Beograd dhe Cetinë pranuan formalisht kushtet ndërkombëtare duke e zbutur presionin në popullatën katolike e myslimane dhe duke qortuar aktorët e këtyre ngjarjeve. Ndërkohë, flota Austro-hungareze më 2 prill 1913, bëri një demonstrim luftarak në detin Adriatik dhe iu afrua Tivarit e Ulqinit, duke detyruar Malin e Zi të tërhiqej nga Shkodra me rrethinat, si dhe për shkak të masakrave malazeze të kryera mbi popullin shqiptar. Ndryshimet politike që ndodhnin në Evropë si: mbajta e Konferencës së Fshehtë të Londrës 1915, si dhe ajo e Parisit 1919, reflektonin dukshëm edhe në terrenin Ballkanik, çfarë nxitnin Serbinë dhe Malin e Zi, që të vazhdonin avazin e vjetër për pushtimin e trojeve shqiptare, çfarë tregohet edhe në memorialet e diplomatit serb, Dimitrije Popoviq, në librin e tij, Lufta Ballkanike, (Balkanski rat, 1912-1913. Beograd, 1993,<sup>472</sup> dhe Branko Babiq i cili rrëfen se nga Gjakova për në Shqipëri emigruan rreth 2.000 banorë.<sup>473</sup> Synimet e qeverisë nuk u ndaluan me kaq, ajo për t'i marrë nën kontroll të plotë në zonat kufitare, në prag të Konferencës ndërkombëtare të Parisit, organizoi ekspedita ushtarake ndëshkuese, të cilat vazhduan edhe gjatë vitit 1918 e 1919, kur në Rugovë u krye gjenocidi më i madh i ndodhur për kohën, në vitin 1918-1919, u vranë dhe masakruan 844 persona.<sup>474</sup>

<sup>472</sup> Dimitrije POPOVIĆ , *Ballkanski Ratovi, 1912-1913*, Srpska Književna Zadruga, Beograd, 1993.

<sup>473</sup> Branko BABIĆ, *Politika Crne Gore u novo oslobođenim krajevima, 1912-1914. vep., e cit., f. 59, 186, 188, 189*. Shtypi Austriak tregon rastin se, në Kosovë, pas largimit të Turkut dhe ardhjes së pushtuesit të ri Serbo-Malazez, më qindra “Laramanë”, të cilët detyroheshin të ktheheshin në ortodokse, kur më këtë rast përzgjidhnin të riktheheshin në Kishën katolike, pushteti Serbo-Malazez, u urdhëronin “ose Mysliman ose Ortodoks, por jo Katolik”. Nga ky represion i kryer në vitin 1913, nga Gjakova më rrethina, për në Shqipërinë veriore, janë shpërngulur, pa kthim 2.000 banorë.

<sup>474</sup> Gjergj (Gjergj) GASHI, *Kosova Altari i Arbërisë, 1910-1941*, në: Biblioteca Apostolica Vaticana, RG. Misceli III. 385, Int 9, Dok, nr. 30 (1-6) , botue Eurorilindja, Tiranë, 1996. f. 267-292.

Në kohën e Lazer Mjedës, (1909-1921) territoreve të Kryedioqezës së Shkupit iu bashkuan Maqedonia dhe Sanxhaku i Novipazarit. Kurse, me lidhjen e marrëveshjes mes Selisë së Shenjtë dhe Serbisë në vitin 1914, kësaj kryedioqeze iu bashkua edhe Monastiri (Bitola) i cili më parë udhëhiqej nga administratori apostolik i Kostandinopojës.

Sipas, relacionit të imzot Lazer Mjedës me 27 maj, 1920, dërguar Propaganda Fides, në Romë, Kryedioqeza e Shkupit kishte këto famulli: Shkupit, me 450 besimtarë; Černagora, 1364; Stublla,

**Dr. Sc. Nikë Ukgjini, Philosophical and Theological Institute,  
Shkodra**

**THE SLAVIC THREAT TO PROVINCE OF RUGOVA  
IN HISTORICAL TRAILS UNTIL 1913**

This province had borne on its shoulders the bad fate of all Albanians caused by the Turks, but also by the Serbs and Montenegrins in particular. The people of Rugova, located in the border zone designated by the Berlin Congress of 1878, inspired by their patriotism and noble spirit, suffered immensely in the struggle for existence and in preserving the eve of their homes, the language and the pure Albanian tradition. Their heroism remains a source of inexhaustible crystal water for many scholars and a great sacrificial example for generations to come. The medieval actions of the Orthodox Church in the new political circumstances in the Balkans, for the Slavization of the Albanians, were both absurd for the time and short-sighted. The Serbian or Montenegrin Orthodox Church, even though they enjoy the status of national autocephalous churches, compared to the Catholic Church, which essentially has the universalism, in this case it acted contrary to the principles of divine laws. Its mission would be to stop violence, murder, torture in general and not, for nationalist interests or according to them to increase the number of believers, to act abusively with the most sacred divine things. The action of the Orthodox Church, for the Albanians to forcibly accept the sacrament of baptism and for the Catholics the rebaptism, had caused a great religious, social, political and national gap, the consequences of which, the people of Rugova and the Albanians in general suffer even to this day as a phenomenon that should never be repeated

---

261; Ferizaj, 125; Mitrovica, 119; Janjeva, 2551, Prizreni (qyteti), 806; Prizreni (fshatrat), 703; Jakova (qyteti), 450; Jakova (fshatrat), 5434; Peja (qyteti), 276; Peja (fshatrat) 4014; Zymi, 896; pra, gjithsej, 17.398, besimtarë.

### Bibliografia

- Babić, Branko (1984). *Politika Crne Gore u novo oslobođenim krajevima, 1912-1914*, Cetinje- Titograd.
- Mandić, Dominik (1967). *Bosna i Hercegovina*, sv. III, Rim.
- Popović, Dominik (1936). *Borba za narodno Ujedinjenje, 1908-1914*, Srpski Narod u XIX veku, knj.7, Beograd.
- Živković, Dragoslav (1992). *Istorija Crnogorskog naroda*, tom II, Cetinje.
- Durham, Edit (1998). *Brenga e Ballkanit*, ribotim, Naum Veqilhaxhi, Tiranë.
- Zenelaj, Eqrem (2010). *Çështja Shqiptare, nga këndvështrimi i diplomacisë dhe gjeopolitikës së Austro-Hungarisë, (1699-1918*, Faik, Konica, Prishtinë.
- Zefi, Frok (2000). *Arqipeshkvija Shkup-Prizren, në shek.. XVIII*, Bashkësia Shqiptare në Prefekturën e Osjekut, Osijek.
- Zefiq, Frok (1997). *Shqiptarët Kelmendas në Hrtkovac e Nikinc (1737-1997)*, Bashkësia Shqiptare në Republikën e Kroacisë, Zagreb.
- Gjini, Gasper (1986). *Skopska – prizrenska biskupija kroz stoljeća*, Drita dhe Kršćanska Sadašnjost, Zagreb.
- Gjini, Gasper (1992). *Ipeshkvia shkup-prizren nëpër shekuj*, Drita, Ferizaj.
- Stadtmüller, Georg (1955). *Die Islamisierung bei den Albanern: Jahrbücher für Geschichte Osteuropas*, N.F. 3, München.
- Grup autoresh, *Rugova*, (1987). monografi, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, libri, 6, Prishtinë.
- Gashi, Gjergj (1996). *Kosova Altari i Arbërisë, 1910-1941*, në: Biblioteca Apostolica, Vaticano, RG. Misceli III. 385, Int 9, Dok, nr. 30 (1-6) , botue Eurorilindja, Tiranë.
- Gashi, Gjergj (1998). *Vatikani dhe Arberia. 1700- 1922*, Onufri, Tiranë.
- Jovanović, Jagosh (1945). *Stvaranje Crnogorske Države*, Narodna Knjiga, Cetinje.

- Radonić, Jovan (1950). *Rimska Kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd.
- Popović, Dimitrij e (1936). *Borba za narodno Ujedinjenje, 1908-1914, Srpski Narod u XIX veku, knj.7*, Beograd.
- Freundlich, Leo (1913). *Albaniens Golgota*, Wien.
- Jačov, Marko (1992). *Le Missioni Cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vol. I, Citta del Vaticano.
- Jačov, Marko (1983). *Spisi tajnog Vatikanskog arhiva od XVI – XVIII veka*, dok. 118, SANU, Beograd.
- Popović, Mihajlo (1933). *Istorijska uloga Srpske Crkve u očuvanju narodnosti i stvaranju države*, Beograd.
- Šufflay, Milan (1916). *Die Kirchengestände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damm: Illyrisch-Albanische Forschungen*, vol I, München und Leipzig.
- Bajraktarević, Mirko (1960). *Rugova, Naselja i poreklo Stanovništva*, knjiga 36, Srpska Akademija Nauka i Umjetnosti, Beograd.
- Ukgjini, Nikë dom (2016). *Kisha katolike në Trevat Shqiptare (Nga shek. XI-deri sot)*, Qendra botuese, Shoqata e Jezuitëve, Tiranë.
- Malcom, Noel (2001). *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë.
- Ražnatović, Novak (1987). *O crnogorsko-primorskoj mitropoliji kao političkom faktoru u Istoriji Crne Gore: Prošlost Crne Gore, kao predmet naučnog istraživanja i obrade*, br. 7, CANU, Titograd.
- Bartl, Peter (1975). *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert: Albanische Forschungen*, band, 15, vol I, dok. 45, botua. Otto Harrassowitz. Wiesbaden.
- Bartl, Peter (1977). *Die Kelmendi. Zur Geschichte eines nordalbanischen Bergstammes: Shejzat*, Roma.
- Thengjilli, Petrika (2002). *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit, (1506-1839), fusha fetare*, botimet Toena, Tiranë.
- *Historia e Popullit Shqiptar* (1994). shkollat e mesme, Tiranë.

- 
- Skendo, Stavro (2000). *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*, Phonix, Shtëpia e librit dhe komunikimit, mendimi shqiptar nr, 6, Tiranë.
  - *Shkrimi i Shenjtë (2011)*. (Bibla) përkthyer nga Dom Simon Filipaj, ribotim, Tiranë.
  - *Shqipnia përpara Konferencës së Paqes*, (Paris 1919) Ble i Parë, Romë, 1919.
  - Harapi, Zef Mark (2004). *Ditt e Trishtimit N'Pejë e Nder Rrethe, 1912-1913*, (Redaktor Dom Nikë Ukgjini), Dukagjini, Pejë.
  - Cana, Zekeria (1996). *Gjenocidi i Malit te Zi, mbi popullin Shqiptar, 1912-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë.